



*Stafi i Kryqit të Kuq Dega Shkodër duke monitoruar shtrirjen e përmbytjeve nga Kalaja e Shkodrës 2010-2011
Foto nga: Kryqi i Kuq Shqiptar*

Kush jemi ne ?

Aleanca e Zyrihut për Aftësinë Ripërtëritëse për Përmbytjet është një bashkëpunim ndërsektorial i fokusuar për gjetjen e mënyrave sa më praktike që ndihmojnë komunitetet dhe vendet në zhvillim për të forcuar aftësinë e tyre ripërtëritëse ndaj përmbytjeve.

Përkufizimi ynë i aftësisë ripërtëritëse:

Aftësia e një sistemi, komuniteti ose shoqërie për të ndjekur objektivat e saj të zhvillimit dhe rritjes sociale, ekologjike dhe ekonomike, ndërkohë që menaxhon rrezikun e tij nga katastrofat dhe përforcon aftësinë e tij ripërtëritëse.

Vizioni: Përmbytjet nuk kanë ndikim negative në aftësinë e njerëzve dhe e bizneseve për të lulëzuar.

Qëllimi ynë: Të rrisim investimet sociale, politike dhe financiare në ndërtimin e aftësisë ripërtëritëse të përmbytjeve në komunitet përmes partneriteteve publike, private dhe sektorit të tretë.



Një e treta e qytetit të Shkodrës e përbytur në 2010-2011

Foto nga: Kryqi i Kuq Shqiptar

Impakti i përbytyjeve në Shqipëri

Shqipëria është një vend që preket shpesh nga përbytytjet, reshjet e dendura dhe infrastruktura jo adekuate kanë rritur ashpërsinë e përbytytyjeve gjatë 15 viteve të fundit kryesisht në zonën veri-perëndimore dhe jug-perëndimore (konkretisht në zonën fushore të nën-Shkodrës, Lezhë dhe ultësirën perëndimore Fier, Vlorë, Lushnjë) si dhe rrëshqitjet e tokës që prekin fshatrat që shtrihen në toka të pjerrëta rrëshqitëse.

Vendi ka kaluar përbytytyje të mëdha gjatë viteve 2010-2011, 2015 dhe 2017.

Tetë lumenj të grupuar në gjashtë basene ujore, që përshkojnë tërthorazi vendin nga lindja në perëndim. Përbytytytjet në Shqipëri janë kryesisht me origjinë pluviale dhe ndodhin kryesisht gjatë periudhës Nëntor-Mars ku vendi merr 80-85% të reshjeve vjetore. Këto pasoja që mund të ishin shmangur nga masa parandaluese, aktualisht janë kthyer më serioze.

Kjo është për shkak të përkeqësimit të sistemeve të digave, kanaleve të kullimit, stacioneve të pompimit, strukturat dhe instalimet e tjera të kontrollit të përbytytyjeve, të cilave u ka munguar mirëmbajtja ose riparimi i rregullt. Për më shumë situata përkeqësohet nga ndërtime pa leje pranë baseneve të lumenjve duke bërë që rrjedhat e ujit të rrjedh në rrugët e qyteteve.

Partneri Aleancës së Zyrihut që punon në Shqipëri

Kryqi i Kuq Shqiptar (KKS) është një shoqatë humanitare e pavarur vullnetare e krijuar me 4 Tetor 1921 në Tiranë duke u bërë shoqata më e vjetër humanitare në Shqipëri.



KKS është njohur njohur nga Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq dhe që nga ky vit është anëtar i Federatës (në atë kohë Ligës) së Shoqatave të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuq. Kryqin e Kuq Shqiptar ushtron veprimtarinë e tij në bazë të nenit 1 të Ligjit Nr.7864 për Kryqin e Kuq Shqiptar të miratuar më 19 Shtator 1994.

Kryqi i Kuq Shqiptar shtrihet në 39 degë në të gjithë vendin, me 2500 vullnetarë aktiv. Shoqata ka arritur një nivel shumë të mirë zhvillimi duke u bërë shoqata më e madhe humanitare në vend. Falë vullnetarëve tanë KKS është prezent në çdo nevojë humanitare që mund të ndodh në shoqërinë tonë, duke qëndruar pranë njerëzve të thjeshtë, familjeve në nevojë dhe komuniteteve të ndryshme të prekura nga katastrofat natyrore.

Aktivitetet bazë të KKS lidhen me sigurimin e ndihmës humanitare gjatë krizave dhe fatkeqësive natyrore, gjithashtu në çdo situatë tjetër vulnerabël. promovimin e shëndetit, zvogëlimin e fatkeqësive dhe rrezikut dhe përfshirjen sociale të grupeve vulnerabël. Ne japim kontributin tonë në përditësimin e njohurive në lidhje me rreziqet dhe vulnerabilitetin, si dhe zvogëlimin e ndikimit të situatave emergjente.

Gjithashtu KKS është i përfshirë në përcjelljen e problematikave dhe interesave të grupeve vulnerabël, duke avokuar tek autoritetet vendimmarrëse.



Vullnetarët e Kryqit të Kuq dega Shkodër duke zhvilluar intervista për Aleancën e Zyrihut
Foto nga: Kryqi i Kuq Shqiptar

Objektivat e Aleancës së Zyrihut në Shqipëri:

- Rritja e kapaciteteve të komuniteteve të përzgjedhura për të planifikuar dhe për t'u përgjigjur/rimëkëmbur në mënyrë efektive nga përmbytjet
- Rritja e njohurive dhe ndryshimi i sjelljes së komuniteteve të zgjedhura për masa efektive për zvogëlimin e rrezikut nga katastrofat.
- Rritja e kapaciteteve të Kryqit të Kuq Shqiptar për të mbështetur ndërhyrjet për zvogëlimin e rrezikut nga katastrofat.

Komunitetet ku ne po punojmë

Shumë veprime për ndërtimin e aftësive ripërtëritëse mund të ndërmerren në nivel komuniteti, pasi komunitetet shpesh e dinë më mirë se si dhe ku kanë nevojë për të krijuar dhe zhvilluar këto aftësi. Duke punuar me komunitetet, ne mund të demonstrojmë ndikim të prekshëm në jetën e njerëzve dhe të mësojmë nga praktikat më të mira, të cilat mund të ndihmojnë në formësimin e politikave në një nivel më të lartë.

Bashkia e Shkodrës ndodhet poshtë tre hidrocentraleve të Fierzës, Komanit dhe Vaut të Dejës. Popullsia që jeton në këtë ultësi shpesh është nën rrezikun e përmbytjeve për shkak të rritjes së menjëhershme dhe të ndjeshme të ujit në këto rezervuare duke detyruar hapjen e portave dhe lëshimin e ujit drejt këtyre zonave.

Zonat kanë përjetuar reshje të vazhdueshme të dendura shiu dhe një proces periodik të shkrirjes së borës në veri dhe veri-perëndim të vendit. Në basenin e lumit Drin, ku janë ndërtuar tre zona ujëmbledhëse për qëllime hidroelektrike, reshjet janë relativisht më të larta se në pjesët e tjera të Shqipërisë, gjë që rezulton në përmbytje të mëdha kur uji nga zonat ujëmbledhëse duhet të lirohet.

Nëpërmjet projektit të Aleancës së Zyrihut për përmbytjet, fillimisht puna filloi në katër njësi administrative në Bashkinë Shkodër: Dajç, Obot, Bërdicë dhe Ajasëm. Këto komunitete janë ndër komunitetet me rrezikun më të lartë të përmbytjeve në shkallë vendi. Ne i përzgjedhëm ata për projektin e aftësisë ripërtëritëse për përmbytjet për shkak të kompleksitetit të problemeve me të cilat përballen, duke filluar nga vendndodhja shumë e rrezikshme e shtëpive të tyre deri tek faktorët që lidhen me koordinimin.

Më pas, projekti u zgjerua dhe në dy komunitete të tjera në jug të vendit, më konkretisht në njësinë administrative Darzezë Bashkia Fier dhe njësia




Qyteti i Shkodrës i përmbytur në 2010

Foto nga: Kryqi i Kuq Shqiptar

administrative Fitore Bashkia Vlorë. Të dy këto njësi të cilat ndodhen në pjesën jug-perëndimore të vendit janë po aq të prekshme dhe vulnerabël nga përmbytjet sa dhe njësitë e përzgjedhura më parë. Kështu projekti me shtrirjen e re mundëson që Aleanca e Zyrihut të jetë prezente në zonat kryesore të rrezikuara nga përmbytjet në.

Kohëzgjatja e programit projektit të Aleancës së Zyrihut në Shqipëri: Shtator 2018- Qershor 2023



Vullnetari i Kryqit të Kuq Dega Shkodër duke zhvilluar intervistë në fshatin Dajç

Foto nga: Kryqi i Kuq Shqiptar

Matja e Aftësisë Ripërtëritëse për Përmbytjet në Komunitete



Një peshkatar nga fshati Dajç/Shkodër duke u intervistuar nga një vullnetar si pjesë e procesit të intervistimit FRMC
Foto nga: Kryqi i Kuq Shqiptar

Matja e aftësisë ripërtëritëse për përmbytjet në komunitete (FRMC) përbëhet nga dy pjesë: kuadri i Aleancës për matjen e aftësisë ripërtëritëse të përmbytjeve të komunitetit dhe një mjet i lidhur direkt me zbatimin e kësaj strukture në praktikë.

Përdorimet e FRMC:

- Si matja e parë e aftësive ripërtëritëse që zbatohet në shkallë të gjerë; i integruar plotësisht me komunitetin
- Për të ndihmuar në analizimin e problemeve para se të kërkon zgjidhje
- Për të mbështetur ndikimin e produktit të matshëm.
- Të gjenerojë të dhëna për dëshmi empirike mbi aftësinë ripërtëritëse ndaj përmbytjeve

Portali i Aftësisë Ripërtëritëse për Përmbytjet

Portalet e Aleancës për Rritjen e Aftësisë Ripërtëritëse janë hapësira online për shpërndarjen e produkteve rreth praktikave më të mira dhe se si të forcojmë aftësitë e komuniteteve ndaj përmbytjeve. Ata sjellin së bashku njohuritë e krijuara dhe të shkëmbyera përmes Aleancës së Aftësisë Ripërtëritëse për Përmbytjeve të Zyrihut dhe më gjerë.

 www.floodresilience.net

 [@floodalliance](https://twitter.com/floodalliance)



Në partneritet me:



Practical ACTION



ZURICH

Anëtarët e Aleancës së Aftësisë Ripërtëritëse për Përmbytjet të Zyrihut financohet nga Fondacioni Z Zyrihut, me përjashtim të Grupit të Sigurimeve të Zyrihut. Sidoqoftë, pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pozicionin zyrtar të Fondacionit ose të Kompanisë.

Kontakt

Kryqi i Kuq Shqiptar

Fatos Xhengo, Koordinator për Përgatitje dhe Përgjigje për Raste Katastrofash dhe Ndhima e Parë në Komunitet,
fxhengo@kksh.org.al

Kryqi i Kuq Shqiptar

Saidi Bushaj, Koordinator i projektit "Flood Resilience",
sbushaj@kksh.org.al